



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal
Mbledhja nr. 07/2017
Prishtinë, më 12.12.2017, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Sala Berisha – Shala, kryetare, Dardan Molliqaj, Hykmete Bajrami, Mimoza Kusari – Lila, Memli Krasniqi dhe Bilall Sherifi, anëtarë.

Munguan: Dardan Sejdiu dhe Adem Hoxha, zëvendëskryetar, Qëndron Kastrati, Gani Dreshaj dhe Duda Balje, anëtarë.

Të ftuar: Arsim Janova, Zyra e Rregullatori për Energji – ZRRE.

Pjesëmarrës të tjerë: Besim Sejfiqaj, Petrit Pepaj dhe Adelina Murtezaj – ZRRE, Etleva Malushaj –GPP/LVV, Dardan Abazi – INDEP, Dorentina Kastrati – BIRN dhe Kaltrina Zymberi – Ekonomia Online.

Stafi mbështetës i komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina, Besim Haliti dhe Veton Raci.

Mbledhjen e kryesoi: Sala Berisha - Shala, kryetare e komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 30.11.2017;
3. Njoftim i Komisionit nga Zyra e Rregullatorit për Energji – ZRRE, rreth Vendimit të Gjykatës së Apelit për pezullimin e Vendimit të ZRRE-së (V-399-2012), dhe vështirësitë me të cilat po ballafaqohet NP KEK, në nxjerrjen e linjitit, si pasojë e mos zhvendosjes së shtëpive në fshatin Shipitullë dhe Hade;
4. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut – KOSTT sh. a, për vitin 2016;
5. Te ndryshme.

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Mimoza Kusari – Lila: Propozoj që të shtohet një pikë e re e rendit të ditës ‘Shqyrtimi i Raportit me amendamente të Projektligjit për Standardizim’, sepse grupi i punës e ka përfunduar punën dhe dje edhe ua kemi proceduar propozim-amendamentet.

Rendi i ditës u miratua njëzëri me propozimin e deputetes Mimoza Kusari – Lila.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 30.11.2017

Procesverbali i mbledhjes, së mbajtur më 30.11.2017, u miratua pa vërejtje.

3. Njoftim i Komisionit nga Zyra e Rregullatorit për Energji – ZRRE, rreth Vendimit të Gjykatës së Apelit për pezullimin e Vendimit të ZRRE-së (V-399-2012), dhe vështirësitë me të cilat po ballafaqohet NP KEK, në nxjerrjen e linjtit, si pasojë e mos zhvendosjes së shtëpive në fshatin Shipitullë dhe Hade

Sala Berisha – Shala, kryetare e komisionit, lidhur më këtë pikë të rendit të ditës njoftoi se ka pasur kërkesë nga vetë Bordi i ZRRE-së, që ta njoftojë Komisionin lidhur me Vendimin të Gjykatës së Apelit për pezullimin e Vendimit të ZRRE-së (V-399-2012), dhe vështirësitë me të cilat po ballafaqohet NP KEK, në nxjerrjen e linjtit, si pasojë e mos zhvendosjes së shtëpive në fshatin Shipitullë dhe Hade, të cilëve ua dha fjalën.

Arsim Janova, Bordi i ZRRE-së, tha se si bord nuk e kemi kuorumin për marrjen e vendimeve për shkak të mosplotësimit. Tani jemi vetëm dy anëtarë por minimum duhet të jemi tre. Ne që nga 1 prilli kemi hyrë në proces të hapjes së tregut të energjisë, kjo periudhe ka qenë sfiduese për ne, sfida e fundit e cila na ka vënë në situatë mjaft të ndërlikuar ka qenë edhe vendimi i Gjykatës Themelore dhe Gjykatës së Apelit. Është fjala për vendimin e ZRRE-së të vitit 2012, vendimi nr. 399 që ka të bëjë me parametrat rregullator ku përfshinë edhe çështjen e lakores së uljeve, për shkallëzimin e humbjeve të energjisë. Ky vendim është kontestuar në qershor nga Institucioni i Avokatit të Popullit, ku ka përgatitur një raport me rekomandime lidhur me këtë vendim dhe çështjen e faturimit të komunave në veri të Kosovës. Ne i kemi kthyer përgjigje Institucionit të Avokatit të Popullit dhe kemi bërë me dije se tani për tani si ZRRE nuk kemi kuorumin për t'i kthyer përgjigje. Mirëpo, pavarësisht asaj, institucioni ka bërë një padi në gjykatë dhe ka kontestuar vendimin nr. 399 të ZRRE-së të vitit 2012, pastaj ne brenda afatit kemi bërë një kundërshtim, mirëpo shumë shpejt Gjykata e Apelit e ka aprovuar vendimin e shkallës së parë. Kemi pasur takime me Kryeministrin, me ministrin e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, i kemi informuar edhe me pasojat eventuale me rastin e ekzekutimit të këtij vendimi. Më 30 nëntor kemi lëshuar një njoftim si të zbatohet vendimi dhe i kemi dërguar KOSTT-it, KEK-ut, KEDS-it, dhe janë informuar të gjitha institucionet me skemën e tarifave pa atë pjesë. Tani pasojat janë shumë të mëdha, ndikon në furnizimin e asaj pjese, pjesa e veriut vazhdon të furnizohet nga KOSTT-i me energji dhe nuk njihen prej tarifave që kanë qenë deri më tani. Ajo vlerë është shumë e madhe rreth 5% ka qenë vjetore e konsumit të Kosovës që është furnizuar vetëm pjesa veriore, atje është furnizuar vetëm me energji nuk ka mirëmbajtje

sepse atje e mirëmban një kompani tjetër që nuk është në kuadër të institucioneve tona. Edhe KOSTT-i, si kompani publike është në një situatë të rëndë dhe ka dërguar një shkresë institucioneve sepse ajo vazhdon ta furnizojë dhe ia kemi bërë me dije se nuk mbulohen ato humbje. Këtu ka qenë një marrëveshje mes Kosovës dhe Serbisë që nuk po zbatohet ende, është në pyetje të futet një operator atje, mirëpo për shkak të mos regjistrimit në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë nuk pranon ndryshimet në status që parashihen me ligjet e Republikës së Kosovës. Nuk ka kushte për të dërguar faturim atje për regjistrimin e konsumatorëve dhe dërgimin e faturave për grumbullimin e mjeteve përmes faturimit. Ulja e prodhimit në KEK ka sjellë telashe edhe në këtë aspekt sepse energjinë që e merrte KOSTT-i nga KEK-u ka qenë më çmim më të lirë, tash duhet ta importojë me çmim të dyfishtë që e rritë koston jo vetëm për pjesën veriore, por edhe për gjithë konsumatorët në Kosovë.

Kryetarja: Çështja e energjisë dhe kjo çka folët deri tani është bukur komplekse, pasi që ne jemi në shturjen e mekanizmave që kanë qenë të përbashkët KOSTT, KEK, KEDS dhe ZRRE. Me lejoni që në letrën e marrë nga 30.11.2017 thuhet: nuk përshkruan e as nuk jep sqarime për mënyrën e mbulimit të kostove për energjinë të dërguar në 4 komunat e veriut të Kosovës, por përshkruan vetëm cakun e zvogëlimit të humbjeve për një periudhë 6 vjeçare për operatorin e sistemit të shpërndarjes nga ZRRE, pika 2 e despozitivit të vendimit, kontestimi i këtij vendimi nga Avokati i Popullit nuk përkon specifikisht me vendimin e lartcekur pasi që nuk ka të bëjë me humbjet në 4 komunat e veriut, dhe as me mbulimin e kostove të këtyre humbjeve, por ka të bëjë vetëm me parametrat rregullator të cilat i ka caktuar ZRRE për të licencuar për periudhën e caktuar. Është pak konfuze kisha dashtë një sqarim më hollësisht të kësaj që është në këtë letër.

Arsim Janova, Bordi i ZRRE-së, tha se është e vërtetë se nëse e shikojmë kontestimi i vendimit nr.399 ky ka parametrat rregullator, mirëpo në bazë të raportit që na ka dërguar edhe Avokati i Popullit dhe fokusi drejtpërdrejt të pjesa veriore e Kosovës, pastaj duke ditur se procesin rregullator dhe tarifave 5 vjeçare është një volum i madh i raporteve të ndryshme që përgatitur dhe i analizave. Në ligj është neni 48 paragrafi 3.3 “Gjatë përgatitjes së tarifave, në tarifa përfshihen edhe humbjet e arsyeshme në sistemin e shpërndarjes dhe transmisionit, humbjet e arsyeshme janë humbjet teknike për shkak të vjetërsisë së rrjetit, humbje komerciale shfrytëzimi i energjisë së pa kontraktuar”, atëherë në vitin 2012 është vlerësuar se është e arsyeshme për shkak të situatës politike sepse s’mund të regjistrohen konsumatorët të faturohen dhe të inkasohen dhe ka hyrë ajo 4,5 ose 5% e humbjeve totale që njihet dhe hynë në tarifa si të rregullta. Pra, neve na lejohet më ligj t’i fatuomë këto humbje në tarifa, ndërsa tash kujt t’ia faturojmë humbjet ne, si ZRRE?

Dardan Molliqaj: Raporti i juaj ishte i mangët dhe qëllimisht ishte i tillë. Për mua është jashtëzakonisht e rëndësishme që në raportin tuaj të flisni edhe për shifra, pra nuk i folët dhe i bëtë me qëllim. Ne duhet të dimë saktë disa pyetje: të dihet se cila është shuma që ne e kemi paguar deri me tani? Në momentin që ju jeni bërë anëtarë të bordit ose nëse keni qenë, a i keni shkruar qytetarëve të Kosovës në faturë që po ua merrni paratë? Unë nuk e kam ditur, për mendimin tim kjo është një vjedhje. Ka qenë obliguese nga bordi i kaluar ose edhe juve që jeni zgjedhur pastaj të njoftoni secilin për këtë çështje. A mund të më tregoni sa janë shumat që qytetarët e Kosovës kanë paguar padrejtësisht dhe të painformuar? Sipas asaj që unë kam lexuar flitet për 8 milionë euro në vit, që i bie se për 17 vjet diku 150 milionë euro, kjo është një vjedhje me letra. Sipas një raportit të Bankës Botërore qytetarët e pjesës Veriore të Mitrovicës i

kanë standardet dy herë më të larta se ata të pjesës Jugore, cili është arsyetimi që ata më standard më të lartë nuk paguajnë e këta me standard më të ultë paguajnë për ta? A mund të me tregoni sa është rritur çmimi i energjisë elektrike prej se është privatizuar rrjeti i distribucionit dhe furnizimit? Sa ka me qenë saktë rritja pasi e cekët që do të ketë rritje të çmimit të energjisë elektrike? Cila ka me qenë politika që do ta ndërroj këtë gjendje? Sa është shuma që deri tani qytetarët e Republikës së Kosovës e kanë paguar - nëse nuk e dini prej pas luftës- prej 2012 deri tani?

Hykmete Bajrami: Së pari kjo çështje është problem politik. E dyta nuk pres nga ZRRE-ja, që të jetë faktori kryesor për implementimin e Marrëveshjes me Serbinë, ajo çka është vërejtja kryesore është se raporti i ZRRE-së karshi KEDS-it. Kur është privatizuar KEDS-i, është privatizuar me qëllim që ne të mos vazhdojmë ta subvencionojmë si ndërmarrje publike, siç i subvencionojmë sot disa kompani. Tash kemi të bëjmë me një operator privat dhe jo publik. Ne, si shtet, nuk kemi nevojë të kujdesemi për punët teknike të një kompanie private. Kërkoj sqarime se lidhur me kushtet e kontratës se privatizimit të distribucionit të energjisë elektrike. Nëse aktorët kanë qenë të përgjegjshëm në institucione kur është privatizuar KEDS-i kanë marrë obligime të tilla po besoj se institucionet e drejtësisë dhe Avokati i Popullit duhet të merren pikërisht edhe me atë. Cilat janë obligimet që ne, si shtet, i kemi marrë karshi një kompanie private që ka privatizuar një aset të madh me vlerë të madhe për 26.3 milionë euro dhe ka arritur që në vitet e para të bëjë fitim prej 40 milionëve eurosh. Mbulimin e humbjeve teknike nuk e kemi pasur për obligim ta bëjmë, cila ka qenë poenta e privatizimit pastaj? Ju si bord duhet të vendosni se çka është e drejtë dhe çka është ligjore për qytetarët e Kosovës, ju duhet të thoni se rryma atje duhet të faturohet dhe ju e dini që me implementimin e marrëveshjeve të fundit komplet administrata atje është shkërrë në institucionet e Kosovës, dhe ata janë në listat e pagave të punëtorëve dhe mund të punojnë në faturimin e energjisë elektrike në atë pjesë. Kërkoj nga Qeveria që me shtri sovranitetin në komunat veriore me e faturuar rrymën. Në asnjë mënyrë nuk kisha dashtë që humbjet teknike me u hequr nga faturat e qytetarëve dhe në anën tjetër me u financuar nga buxheti i Kosovës, sepse prapë i bie e njëjta që nga taksat e qytetarëve të paguhen humbjet. Është e papranueshme që qytetarët të paguajnë humbjet teknike të një kompanie private.

Mimoza Kusari- Lila: Në raportin tuaj janë disa elemente që duhet të ndalemi t'i sqaromë, që së pari ju e cekët që mirëmbajtja e rrjetit në pjesën Veriore bëhet nga disa kompani të cilat nuk janë nën kontroll të Kosovës përderisa furnizimi nga KOSTT bëhet në vazhdimësi, sa e keni vlerësuar që rriten shpenzimet në raport me strukturën atje të rrjetit për derisa nuk keni kontroll në rrjetë, ndërsa furnizimi shkon dhe atë çka e thanë kolegët si është bërë faturimi pasi nuk ka matje të sakta të shpenzimit pasi ne nuk e kontrollojmë rrjetin në veri të Kosovës. A mundeni me na treguar sa është rritur kostoja e furnizimit me rrymë elektrike në Kosovë në ditët të cilat po flasim kur po ballafaqohemi me krizë të mos zhvendosjes së banorëve të Hades? Gjithashtu në rast se do të ndodhte një zhvendosje e tillë, sa kohë ju e vlerësoni në aspektin profesional që duhet për normalizim të prodhimit dhe furnizimit me energji elektrike? Në aspektin e zhvillimit të politikave afatgjate, në cilën fazë jeni në përcaktimin të fillimit të tarifave për energjinë e ri përtëriteshme? Si e shihni ju procesin e përcaktimit të tarifave dhe kur këto mund të prezantohen për Kosovën si një vend me tarifa të kompletuara për të gjithë që janë të interesuar në aspektin e prodhimit të energjisë së ripërtëritshme?

Memli Krasniqi: Në këto pesë vjet, sa është totali i përgjithshëm, nëse keni shifra dhe po ashtu çka mendoni të bëni në të ardhmen? A keni diskutuar me Qeverinë pasi thatë se keni pasur takime edhe me kryeministrin, a keni diskutuar se si do të dilni nga kjo situatë? Sepse po flasim për një shumë e cila nuk do të inkasohet. Nëse situata vazhdon dhe nuk ka zhvendosje të banorëve të Shipitullës dhe Hades, sa ditë ka KEK-u që të nxjerrë linjit para se të ballafaqohet me mungesa të rezervave të linjtit për prodhim? Nuk na takon si Komision ta luajmë rolin e gjykatësit sepse këtu kanë ardhur ZRRE të raportojnë për përgjegjësit që i kanë dhe që ua kemi mveshur. Është mirë të na tregojnë si kanë ardhur deri te ky vendim, si ka qenë konteksti deri te marrja e vendimit nr.399, dhe cila është rrugëdalja pas pezullimit të tij?

Arsim Janova, Bordi i ZRRE-së, tha se shifrat të cila u përmenden nga zotëri Molliqaj, janë mesatare 8 milionë euro vjetore për pjesën Veriore dhe sillet 4,5-5% sepse ndryshon nga viti në vit varësisht prej furnizimit. Ky ishte vetëm një njoftim dhe ashtu e keni në rendin e ditës, mirëpo, ne kemi sjellë edhe raporte në të kaluarën të cilat janë të detajuara. Prej vitit 2011 deri tani janë paguar për veriun 53 milionë euro.

Dardan Molliqaj: A është paguar edhe më herët?

Arsim Janova, Bordi i ZRRE-së, tha se rregullisht ka qenë pjesë e pagesës për Veriun, sepse me herët në 2013 është privatizuar KEDS-i, Qeveria ka subvencionuar KEK-un, që ka qenë si kompani e unifikuar furnizimi, shpërndarja e transmisioni. Shthurja është bërë njëherë KOSTT-i, pastaj KEDS-i dhe KESCO, me ligjin e ri aksionar i KOSST-it është Kuvendi i Kosovës. Ne në Bord jemi që dy vjet. Ne s'mund ta predijudikojmë vendimin derisa gjykata ta sjellë atë vendim që ka qenë në kundërshtim me ligjin, pra vendimin përfundimtar sepse tani kemi masë të përkohshme. Sa i përket njoftimit të qytetarëve, çdo herë për përgatitjen e tarifave bëhen edhe diskutime publike. Nuk është precizuar në faturë ajo se sa është pjesa se sa paguhet për veriun, mirëpo, ne kemi njoftuar edhe komisionin parlamentar për pjesën e veriut, dhe kemi kërkuar zgjidhje. Humbja teknike është e rregulluar me ligj dhe ashtu si e rregulloni ju ligjin ne e zbatojmë, dhe nuk shkruan as për kompani private, as për shoqërore e publike. Sepse nëse ne do të vepronim ndryshe për humbjet teknike, ju do të thoni që nuk po e zbatojmë ligjin. Raporti i ZRRE-së në raport me KEDS-in është raport i njëjtë me të gjithë të licencuarit si me KOSST-in. Rritje të tarifave për dy vjet nuk ka pasur, vitin e kaluar ka pasur një zbritje për 8% për biznese. Këtë vit kemi bërë vetëm ndryshim të strukturës tarifore që ka hyrë në fuqi më 1 prill 2017. Rritje ka pasur vetëm në kohën kur ka ndodhur eksplodimi në Kosovën A sa i takon shpronësimit, kjo çështje i takon qeverisë sepse ajo ndërmarrje është publike dhe aksionare është Qeveria. Mirëpo, sa ka impakte në sigurinë e furnizimit me energji dhe sa do të ketë impakte në tarifa është çështje e jona që jemi duke e përcjellë. Për energjinë e ripërtëritëshme, në bazë të një udhëzimi administrativ të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, sepse Qeveria përmes kësaj ministrie përcakton caqet për energjinë e ripërtëritëshme qoftë për solare, hidrocentrale, është paraparë që deri në 2020 të plotësohen ato caqe, 250 janë për hidrocentrale, 140 janë për erë, 10 Mega vat janë paraparë për solare, mirëpo me një udhëzim të ri ato janë rritur në 30 Mega vat, me biomasë kanë qenë 14, tash edhe ato me të njëjtin udhëzim janë rritur në 20 Mega vat.

Hykmete Bajrami, replikoj, dhe tha se problemi i gjendjes në veri është problem politik! Ju keni një mandat dyvjeçarë, ndërsa vendimi ishte marrë më 6 shkurt 2012, por ju thatë që nuk na intereson a është operatori privat apo publik.

Arsim Janova, Bordi i ZRRE-së, tha se është vetëm për humbje teknike.

Hykmete Bajrami: Edhe unë e kam fjalën pikërisht për humbje teknike. Ne e kemi shumë të qartë se si rezultat i mos faturimit të energjisë elektrike në veri ajo energji elektrike faturohet si humbje teknike për këtë arsye qytetarëve nuk ju shkruan në fatura që është rryma e veriut, por ju shkruan 6% është humbje teknike kështu është a po?

Arsim Janova, Bordi i ZRRE-së, tha se po aty hyn në çështje komerciale dhe teknike.

Hykmete Bajrami: Duhet me ndërruar raporti sepse kur ka qenë ndërmarrje publike e kemi subvencionuar përmes buxhetit të Republikës së Kosovës, që është pikërisht e njëjta gjë sikur ta paguajmë me faturë, sikur ta paguajmë me taksa është e njëjta gjë. Arsyeja pse është privatizuar dhe pse privatizohen ndërmarrjet publike sepse si sistem ka dështuar dhe s'ka qenë profitabil. Raporti i ZRRE-së duhet të ndërrojë karshi operatorit privat dhe është shumë gabim që nuk ka ndërruar, vendimi është marrë në vitin 2012, ndërsa, privatizimi ka ndodh në vitin 2013, automatikisht është dashtë me ndërruar. Nuk duhet ne, si shtet, për një kompani private me marrë përsipër kushtet ose nëse kjo ka qenë kusht i privatizimit, atëherë kjo është diçka tjetër.

Bilall Sherifi: Kam disa pyetje sqaruese: a është faturuar humbja në Veri, si humbje teknike apo me ndonjë vendim të veçantë për shkak të pamundësisë së zbatimit të marrëveshjes është inkasuar? A është edhe me kontratë me kontratën e shitblerjes me KEDS-in që të mbulohen humbjet teknike apo nuk është në kontratë? A parashihet në kontratën që e ka bërë Qeveria me KEDS-in në momentin kur e ka shitur komplet kompaninë? Ligji thatë që është bërë në 2016, neni në fjalë a ka qenë edhe më herët apo është integruar në ndryshime? Nëse ligji e mbulon që faturat e veriut të mbulohen si humbje teknike, nuk mund ta arsyetosh sepse ju detyron ligji dhe kjo është çështje e Kuvendit ta ndërrojë ligjin.

Hykmete Bajrami tha se neni 48 i ligjit për ZRRE-n, i vitit 2016 që u fol për tarifa, pika 3.3 është paragrafi më i afërt i cili nuk e arsyeton vendimin e 6 shkurtit 2012. Pika 3.3 thotë “duhet të përfshihen kostot e niveleve të arsyeshme të humbjeve të energjisë në sistemet e transmetimit dhe shpërndarjes”, nëse me këtë doni ta mbuloni kjo nuk është në ligj nëse jeni duke ju referuar kësaj.

Dardan Molliqaj: Kërkoj që ta ftojme ministrin e Zhvillimit Ekonomik ose nëse ne duhet të votojmë që t' i ftojme edhe kolegët e tjerë që ai të jetë këtu. U shpjegua se është rritur 4.8% çmimi i energjisë, që për mua është shumë për këtë periudhë, pavarësisht shpjegimeve që po bëhen sepse të mos harrojmë privatizimi i rrjetit të shpërndarjes dhe furnizimit ka qenë që çmimi do të jetë më i lirë dhe më i favorshëm për qytetarët. Ajo çka kuptova është se prej 2011 janë 50 e disa milion euro që janë paguar, prej asaj që kam lexuar ne paguajmë për veriun prej pasluftës. Nuk është në rregull të thirreni të çështja e marrëveshjes sepse marrëveshja për energji përveç që është e dëmshme dhe e padrejtë ajo ka ndodhur në 2013. Ne kemi paguar edhe kur s'ka pasur marrëveshje, nuk është çështje e zbatimit të marrëveshjes. Unë kam problem me

vendimin e dytë që ju paskeni marrë si bord ekzistues, prej asaj që unë kam përllëgarit, harmonizimi dhe heqja e blloqeve e dëmton shpenzuesin e vogël të energjisë elektrike që jemi shfrytëzuesi më i madh, pra amvisëria. Nuk treguat cilat janë parashikimet e viteve të ardhshme, cilat i sheh si pritje dhe si rrezik?

Kryetarja: Edhe ne, si deputetë, por edhe si qytetarë duhet të jemi më aktivë në përcaktimin e jetës sonë sepse edhe tarifat e energjisë edhe çështje e tjera janë në diskutim publik, ku këta janë të obliguar t'i marrin edhe sugjerimet sidomos nga ana e ekspertëve. Sepse jo secili qytetar e ka sensin ta kuptojë se si shkojnë, si caktohen tarifat, nuk ka mundësi të gjithë ta kuptojnë atë procedurë. Të gjitha institucionet duhet të kultivojnë transparencën para qytetarëve dhe para institucioneve të tjera siç është parlamenti.

Arsim Janova, Bordi i ZRRE-së, tha se një sqarim në paragrafin që e lexoj deputetja Hykmete Bajrami, te këto humbje do të thotë në ligj nuk ceket a janë teknike apo komerciale, por humbjet e arsyeshme. Rregullatori e ka autoritetin të vlerësojë cilat janë humbje të arsyeshme. Humbjet teknike janë humbjet në rrjet për shkak të vjetërsisë, dhe ka qenë sepse janë praktika edhe në rajon. Pjesë e humbjeve teknike është pjesa për veriun, si do ta quajmë teknike apo politike. Te heqja e blloqeve ka pasur shumë debate sepse ne i mbrojmë konsumatorët, por ka pasur probleme të natyrave të ndryshme, dhe kërkesa të shumta. Ne kemi paraparë që ky vit të jetë një lloj i vitit testues për neve. Tani do të bëhen analiza në raport me vitin paraprak. Po kthehem pak te KEK-u siç jeni të informuar diku prej 1 nëntorit KEK-u është duke prodhuar me 50 % të kapaciteteve, rreth 400 Mega vat, dy blloqe, një i Kosovës A dhe një i Kosovës B. Përgjysmimi i kapaciteteve të prodhimit ka shkaktuar probleme të mëdha jo vetëm humbje që diku 8 milionë euro më pak të hyra kanë ata sepse nuk kanë atë energji t'ia shesin KESCO-s. Tash sipas KEK-ut nëse fillojnë qysh tash ta vazhdojnë mihjen në Shipitullë dhe Hade, pas 6 muajve mbërrin ta nxjerrin thëngjillin. Rezervat që i kanë 1 400 000 ton ata kanë llogaritur të vazhdojnë 3-4muaj me këto kapacitete që janë duke prodhuar. Çka do të thotë, se nëse në Janar dhe Shkurt rritet çmimi, sepse vitin e kaluar ka shkuar importi në 300 euro për Mega vat, tash ose duhet të shtohet importi ose duhet të bëhen reduktime sepse s'mund ta mbulojë me tarifa sepse tarifat do të jenë aq të mëdha dhe të papërballueshme për konsumatorët.

Dardan Molliqaj: E para, sa i përket blloqeve dhe harmonizimeve, po më vije keq po s'keni pasur nevojë të bëni vit testues e keni pasur vitin paraprak. Nuk është në rregull sepse po e dëmtoni qytetarin e Kosovës, mos bëni eksperimente ku miliona euro u janë marrë qytetarëve për testim. Nuk e kam të qartë a jemi ne të obliguar si shtet që KEDS-it t'ia prodhojmë energjinë elektrike apo KEDS-i me kontratë e ka për obligim me furnizuar Kosovën me energji dhe me e shpërnda.

Sa i përket çështjes së mihjes, e kam parë që kërkesa për shpronësim në Hade dhe Shipitullë ka arritur rreth 25 milionë nga 4.5 milionë sa ka qenë më herët pra pesëfishim. Në këto territore kanë qenë ndërtim 50-60 shtëpi prej vitit 2009, ndërsa tash ka më shumë, sipas informatave që i kam çmimi i shtëpisë atje është më i shtrenjtë se i cilësdo shtëpi ekskluzive në Prishtinë. Kështu që është shkel ligji, dhe tash nuk po kuptoj çka ka ndodhur këtu, ose ka përfitime nga të gjitha anët të grupeve të interesit.

Mimoza Kusari –Lila: Ta kemi të çartë për çka është ZRRE këtu, për çka është Qeveria edhe Parlamenti? Problemi i zhvendosjes, përcaktimit të çmimit dhe shpalljes së interesit strategjik

është ekskluzivisht kompetencë e qeverisë, edhe ekskluzivisht qeveria duhet t'i thërras në llogari qoftë edhe në interpelancë kryeministri bashkë me ministrat e linjës për atë se sa peshë ka kjo që po flasim. Përderisa sa i përket furnizimit e tha në fillim z. Janova, që është bërë ndarja e korporatës, gjenerimi është veç, distribucioni veç. Ne e kemi privatizuar distribucionin është një model i përgjithshëm dhe natyrisht secili pa marrë parasysh, a është kjo kompani apo dikush tjetër në cilindo rast gjenerimi dhe distribucioni janë të lidhura duhet të sigurohet energji. Kjo çka po ndodh është problem, i cili nuk targetohet me ZRRE, ky është problem i cili lidhet drejtpërdrejt me performancë të qeverisë, duhet qeveria të thirret në interpelancë sa më shpejtë dhe të diskutohet dhe trajtohet pse po bëhen eksperimente dhe pse kaq jo seriozitet prej qeverisë dhe prej kryeministrit i cili bën marrëveshje, shfuqizon vendime, kthen vendime prapë.

Kryetarja: Ne e kemi thirrur Ministrin e Zhvillimit Ekonomik z. Lluka, në një takim të Komisionit, mirëpo, në mungesë kuorumi nuk e kemi mbajtur atë takim. Ne, si Komision, kemi obligim të thërrasim në raport ministrat e linjës që t'i përgjigjen komisionit parlamentar. Prandaj shumë çështje dhe pyetje që u shtruan këtu nuk janë në adresë të ZRRE-së e cila sot ka ardhur për një njoftim por janë në adresa tjera të sektorit të energjisë.

Dardan Molliqaj: Unë i kam të qarta kompetencat e ZRRE-së, i kam të qarta edhe kompetencat e qeverisë, por institucionet ndonëse quhen të pavarura janë zgjatim i politikave të qeverisë nuk janë të shkëputura. Unë nuk e di kur ishte ministri, por sigurisht në kohë të fushatës që ishte e pamundshme të vijë unë. Gjendja qenka alarmante, paska filluar të bëhet problem prej 1 nëntorit, me atë që kuptova tash nga z. Janova. Unë kisha dashtë që edhe nëse fillojmë sot me punuar në mihje 6 muaj i kemi, dhe për 6 muaj do të kemi një humbje shumë të madhe. Duhet ta dimë se kush janë në këto 260 shtëpi.

Kryetarja: Mendojë se në këtë Komision është një frymë që të gjithë jemi për të punuar dhe për të zbardhur të vërtetën, në këtë komision e kemi marr një qëndrim dhe vendim që ta monitorojmë zbatimin e Ligjit për Energji Elektrike, ai zbatim i ligjit nuk ka filluar ende, grupi punues nuk është duke punuar.

Bilall Sherifi: Raporti im me përfaqësuesit e ZRRE-së, nuk është në atë që t'i ngarkojmë me përgjegjësi që nuk i kanë! Unë pyeta dhe po e përsëris pyetjen. Besoj që duhet ta njihni kontratën më mirë se çdo qytetar po supozojë kontratën e shitjes së KEDS-it, a është e paraparë në kontratë që Kosova është e detyruar ta furnizojë me rrymë apo ajo është thjesht një operatorë tregtarë që blenë rrymë me shumicë dhe shet me pakicë? Sa i përket asaj që ju thatë ligji parashih të subvencionohen. Unë mendoj që nuk është e drejtë që kompanitë private të subvencionohen sepse qëllimi i privatizimit ka qenë shteti të lirohet nga barra e subvencionimit. Kompanitë publike jorentabile i mbanë shteti sepse ato nuk vjen askush t'i blejë sepse nuk arrin fare të sjellin fitime.

Arsim Janova, Bordi i ZRRE-së, tha se sa kam dijeni marrëveshja që ka qenë atëherë e shitjes e KEDS-it, se më vonë është ndarë edhe KESCO, sepse kanë qenë bashkë, parashihet se tërë energjia që prodhon KEK-u, t'i shitet atëherë KEDS-it, tash KESCO-s furnizues dhe energjinë e mbetur mund ta shesë në treg.

Kryetarja: Kush ta shesë në treg?

Arsim Janova, Bordi i ZRRE-së, tha se KEK-u e shet, e eksporton natën, ka eksportuar, por me çmim më të ulët, sepse i ka plotësuar kërkesat, nominimet i bën KESCO, dhe natën ka eksportuar, nuk e ka pas problem. Tash prej 1 prilli të këtij viti, kur ne e kemi çrregulluar KEK-un nuk i rregullojmë tarifatat e KEK-ut, çmimet që ia shet KESCO-s. Por në një mënyrë ne në bazë të parametrave pak ia kemi diktuar edhe KEK-ut, çfarë çmimi të mbajnë për t'i ruajtur konsumatorët e rregulluar. Vitin e kaluar i kemi licencuar edhe dy furnizues, por nuk kanë filluar të punojnë ende sepse atë e përcakton tregu. Për energjinë që e kemi për furnizim universal që e bënë KESCO ne e kemi çmimin për konsumatorë për atë është i obliguar KEK-u, edhe tash ta furnizojë aq sa prodhon, pjesën tjetër mund ta eksportojnë.

Dardan Molliqaj: Çka nëse prodhon ma pak se nevojat?

Arsim Janova, Bordi i ZRRE-së, tha se e ka obligim me furnizuar, ky është furnizues se nuk është prodhues.

Dardan Molliqaj: Kush e ka obligim?

Arsim Janova, Bordi i ZRRE-së, tha se KEDS-i.

Dardan Molliqaj: Pse duhet me rritur çmimin atëherë për kompani private?

Arsim Janova, Bordi i ZRRE-së, tha se po ai e blen. Lëvizja në bursa është qysh lëvizë çmimi, lëvizja e çmimit është por ne ia përcaktojmë disa parametra që me çfarë çmimi e blen prej KEK-ut, por jo me çfarë e blen prej jashtë, çfarë e importon sepse është treg. Ne ia kemi përcaktuar 28.6 euro me ble prej KEK-ut, për shërbim universal, për furnizim të gjithë konsumatorëve që janë të rregulluar. Për humbje që bëhen teknike ka 35.4 euro e ka prej KEK-ut, që e blen, domethënë e ka me çmim më të lartë, por nëse nuk prodhon KEK-u atë energji që duhet t'i plotësojë nevojat e blen në treg me import ajo varet sa shkon tregu dhe e shpërndanë në tarifa.

Bilall Sherifi: Këtu ne s` paskemi një rregullim?

Arsim Janova, Bordi i ZRRE-së, tha se jo rregullim për importe, do të thotë ne e kemi me çmimin, por atëherë importi që vjen ajo e rrit koston e të hyrave maksimale të sektorit, domethënë me import. Ne edhe në kushte normale sa e furnizon për importe ja njohim një pjesë që e lejojmë, fillimisht në vjetore e kemi 24-25 milionë euro për importe. Por tash meqenëse po rritet importi shumë jashtë asaj që e kemi parashikuar atëherë ajo duhet t'i mbledh veglat dhe të ecë.

Dardan Molliqaj: Po supozojmë që rritet 11 milionë çmimi i energjisë që duhet me e ble ne, ju që e rregulloni çmimin për konsumatorë për KEDS-in, a i ndani 5.5, 5 i merr konsumatori e 5.5 i merr kompania, apo në krejt atë rritje të çmimit duhet të paguajë konsumatori?

Arsim Janova, Bordi i ZRRE-së, tha se fitimin e ka aq sa e ka me përqindje, sa për qind e ka fitimin e ka për investime, do të thotë e ka përqindjen e vetë që e ka ajo gradualisht ajo mbetet në përqindje, raporti i njëjtë mbetet sepse e rrit koston e gjithë të hyrave maksimale për sektorin. Tarifa, metodologjia, e këto janë krejt me standarde ndërkombëtare që janë në rajon, për tarifa vetëm Serbia i ka këto tarifa në rajon, më të lirat i kemi ne. Sa të lejosh më shumë me pasur të hyra, tarifat rriten më shumë! Ne mundohemi ta mbajmë një balancim sepse është Rregullator duke e ruajtur konsumatorin dhe duke e ruajtur kompaninë të zhvillohet se ne nuk të interesuar ta shuajmë një kompani. Që 8 muaj kemi filluar përgatitjen e tarifave për periudhën 5 vjeçare të ardhshme që duhet shumë analiza dhe çdo gjë, çdo projekt që konkurrojnë kompanitë që ia rregullojnë KOSST-i, KEDS-i KESCO, çdo projekt shkon një për një dhe analizohet a ka arsye apo jo, lejohet apo nuk lejohet, dhe çdo gjë që lejojnë ndikon drejtpërsëdrejti në tarifa, pra do të thotë rritje të tarifave të konsumatorit.

Pas debatit, komisioni njëzëri nxori këtë:

Përfundim

Kryetari i Kuvendit të kërkojë nga Qeveria për të proceduar sa më shpejtë që është e mundur, kandidatët për anëtarë të Bordit të ZRRE-së, në përputhje me Ligjin.

Në mungesë të kuorumit, kryetarja ndërpreu mbledhjen.

* * *

Vazhdimi i mbledhjes më 13.12.2017, në orën 11:00 salla N-303, ndërtesa e Kuvendit.

Pjesëmarrës/Komisioni: Sala Berisha – Shala, kryetare, Dardan Sejdiu, zëvendëskryetar i parë, Adem Hoxha, zëvendëskryetar i dytë, Hykmete Bajrami, Bilall Sherifi dhe Duda Balje, anëtarë.

Mbledhjen e kryesoi: Sala Berisha - Shala, kryetare e komisionit.

Kryetarja tha se po e vazhdojmë mbledhjen e ndërprerë më 12.12.2017, për shkak të mungesës së kuorumit, mirëpo, tha se kam njoftim nga Bordi i KOSTT-it që për shkak të një takimi të rëndësishëm, ata nuk mund të jenë sot prezent në mbledhje, por po vazhdojmë më pikën tjetër të rendit të ditës “Shqyrtimi i Raportit me amendamente të Projektligjit për Standardizim”. Ajo prezantoi amendamentet e grupit të punës dhe i hodhi në votim si vijon:

Amendamenti 1

Miratohet.

Amendamenti 2

Miratohet.

Amendamenti 3

Miratohet.

Amendamenti 4

Miratohet.

Amendamenti 5

Miratohet.

Amendamenti 6

Miratohet.

Amendamenti 7

Miratohet.

Amendamenti 8

Miratohet.

Amendamenti 9

Miratohet.

Amendamenti 10

Miratohet.

Amendamenti 11

Miratohet.

Amendamenti 12

Miratohet.

Amendamenti 13

Miratohet.

Amendamenti 14

Miratohet.

Amendamenti 15

Miratohet.

Amendamenti 16

Miratohet.

Amendamenti 17

Dardan Sejdiu kërkoi që fjalia “Standardet kosovare” të bëhet “Standardet e Republikës së Kosovës” dhe ky ndryshim të reflektoj në përkufizime dhe në tërë tekstin e ligjit.

Propozimi u përkrah nga Komisioni, duke shtuar edhe një amendament të ri të përkufizimet, përkatësisht në nenin 3, nënparagrafi 1.12.

Amendamenti 18

Miratohet.

Komisioni, unanimisht nxori këtë:

Përfundim

- 1. Miratohet Raporti me amendamente i Projektligjit nr.06/L-019 për Standardizim.*
- 2. Raporti me amendamente i Projektligjit nr.06/L-019 për Standardizim procedohet në komisionet e përhershme për vlerësim sipas kompetencës.*

Raporti me Amendamente i bashkëngjitet këtij procesverbali.

5. Të ndryshme

Çështjet vijuese.

Mbledhja përfundoi në orën 11.30.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit

Kryetare e komisionit,

Sala Berisha – Shala



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni vjeshtor

Për: Komisionet e përhershme të Kuvendit të Republikës së Kosovës;

Komisioni për Buxhet dhe Financa;

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim;

Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë Kosovare kundër Korrupsionit;

Komisioni për Integrime Evropiane;

Nga: Komisioni funksional për Zhvillim ekonomik, infrastrukturë, tregti, industri dhe zhvillim rajonal;

Lënda: Raporti me Amendamente i Projektligjit nr.06/L-019 për Standardizim;

Datë: 13.12.2017, Prishtinë;

Në bazë të nenit 57 dhe 68 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Komisioni funksional për Zhvillim ekonomik, infrastrukturë, tregti, industri dhe zhvillim rajonal, me datë 13.12.2017, e shqyrtoi dhe amendamentoj Projektligjin nr.06/L-019 për Standardizim dhe, procedon në Komisionet e përhershme për vlerësim sipas kompetencës, si në vijim:

Amendamenti 1

Neni 3, nën-paragrafi 1.3, riformulohet si vijon:

1.3. Organi Nacional i Standardizimit - organ i standardizimit në nivel shtetëror të një shteti tjetër;

Amendamenti 2

Neni 3, nën-paragrafi 1.8; 1.9; 1.10; 1.11; 1.12 dhe 1.13; riorganizim të nën-paragrafit 1.8. respektivisht nën-paragrafët 1.9.; 1.10.; 1.11.; 1.12.; dhe 1.13.; kalojnë si nën nën-paragrafë të nën-paragrafit 1.8. Ndërkaq nën-paragrafi 1.14. bëhet nën-paragraf 1.9.

Amendamenti 3

Neni 3, nën-paragrafi 1.12. pas fjalës “standard” shohet fjalia “i Republikës së Kosovës”.

Amendamenti 4

Neni 3, nën nën-paragrafi 1.16.5. Specifikim teknik i TIK - bëhet nën-pagaragaf në vehte.

Amendamenti 5

Neni 3, nën-paragrafi 1.23. riformulohet si vijon:

1.23. Palë e interesit - person juridik ose fizik që në mënyrë direkte ose indirekte gjenden në një raport të caktuar me institucionin përkatës të standardizimit.

Amendamenti 6

Neni 3, i shtohet edhe një nën-paragraf i ri si vijon:

Notifikimi - procesi i njoftimi të miratimit të standardeve nga Agjencia e Standardizimit të Kosovës në Organizatën Botërore të Tregtisë.

Amendamenti 7

Neni 4, riformulohet si vijon:

Standardizimi mund të ketë një apo më shumë objektiva për përshtatje të një produkti, procesi apo shërbimi. Objektivat e tilla nuk kufizohen me kontrollin e diversitetit, përdorimit, pajtueshmërisë, ndërkëmbimit, shëndetit, sigurisë, mbrojtjen e mjedisit, mbrojtjen e produktit, marrëveshje të ndërsjella, performancën ekonomike dhe tregtinë.

Amendamenti 8

Neni 5, paragrafi 1, fjalia e fundit “kontratë apo ligj.” zëvendësohet me “kontratë, ligj ose më akt nënligjor.”.

Amendamenti 9

Neni 6, riformulohet si vijon:

1. AKS është organ i pavarur dhe i vetmi si i tillë i administratës shtetërore, përgjegjës për standardizim në Republikën e Kosovës, i cili përfshinë zhvillimin, njohjen, adoptimin, miratimin dhe publikimin e standardeve për të gjithë sektorët e ndërlidhur me dispozitat e këtij ligji, i cili vepron në kuadër të ministrisë përkatëse për tregti dhe industri.

2. Struktura dhe organizimi i AKS së, siguron paanshmëri dhe objektivitet në marrjen e vendimit për standardizim.

3. AKS udhëhiqet nga Drejtori i Përgjithshëm.

4. Ligji për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës do të zbatohet për organizimin dhe funksionimin e AKS-së, përveç nëse përcaktohet ndryshe me këtë ligj.

5. Organizimi dhe struktura e AKS së, rregullohet përmes aktit nënligjor, i propozuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë dhe miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Amendamenti 10

Neni 8, paragrafi 1, fjalia “standardizimin kosovar” zëvendësohet me “Republikën e Kosovës”.

Amendamenti 11

Neni 10, pas paragrafit 2, shtohet një paragraf i ri si vijon:

3. Standardet në fushën e elektroteknikës janë përgjegjësi e Komitetit Elektroteknik që vepron në kuadër të AKS.

Amendamenti 12

Neni 13, fjalisë “1. Së paku një herë në vit,” i shtohet fjalia “brenda tremujorit të parë,”.

Amendamenti 13

Neni 13, nën-paragrafi 4.2., fjalla “organeve” zëvendësohet me “trupave”.

Amendamenti 14

Neni 13, paragrafit 5, i shtohet fjalia “ka për qëllim:”.

Amendamenti 15

Neni 13, paragrafi 6 riorganizohet, ku pjesa e paragrafit 6 fshihet, ndërsa dy nën-paragrafet 6.1 dhe 6.2 behën paragraf të ri, si 6 dhe 7 të këtij neni.

Amendamenti 16

Neni 14, paragrafi 1, fjalia e fundit “kontratë apo ligj.” zëvendësohet me “kontratë, ligj ose më akt nënligjor.”.

Amendamenti 17

Neni 14, paragrafi 3, fjala “rregullator” zëvendësohet me “rregullues”.

Amendamenti 18

Neni 22, ndryshohet si vijon:

1. Standardet e Republikës së Kosovës, të emërtuara me shkronjat SK, të cilat janë njohur, adoptuar apo miratuar përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, e ruajnë vlefshmërinë edhe pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

2. Agjencia e Standardizimit e Kosovës në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë e themeluar me Ligjin Nr. 03/L-144 për Standardizimin, do të vazhdojë të gjitha aktivitetet si ASK në përputhje me këtë Ligj. Aktivitetet e standardizimit të cilat kanë filluar përpara hyrjes në fuqi të këtij Ligji, do të finalizohen në pajtim me këtë Ligj dhe me aktet nënligjore që derivojnë nga ky Ligj.

Amendamenti 19

Pas Nenit 22, të shtohet një nen i ri si vijon:

Neni 23

Nxjerrja e akteve nënligjore

1. Aktet nënligjore të përcaktuara me këtë ligj, nxirren brenda një viti pas hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe të njëjtat miratohen dhe nënshkruhen nga ministria përkatëse për tregti dhe industri.

Kryetarja e Komisionit

Sala BERISHA - SHALA